

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Menaxhment Financiar  
(zgjidhjet)**

**P7**

Nr.

**FLETË PROVIMI**  
Exam Paper

**Udhëzime/Instructions:**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ  
MBIKËQYRËSIT  
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA  
PYETJEVE  
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË  
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË  
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.  
Your name should appear nowhere in this test

**Data: 01.08.2020**

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	25	
4. Problemi 4	25	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Pastrimi Shpk është një kompani inovative e themeluar në vitin 2020. Momentalisht ka një produkt në treg, 'Robostrimi', një pastrues robotik për pastrimin e dysHEMEVE. Ky produkt ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Kompania tani është duke zhvilluar një pastrues robotik të quajtur 'Robonona' e cila thithë me vakum pluhurin dhe e shtypë atë.

Deri me sot €120,000 janë shpenzuar në zhvillimin e produktit. Kompania poashtu ka pasur €250,000 kosto të hulumtimit të tregut, edhe pse fatura e këtyre kostove sapo është pranuar dhe do të paguhet në janar.

Pasi që kostot e përgatitjes janë domethënëse, duhet të merret një vendim përfundimtar nëse është e arsyeshme të prodhohet dhe shitet 'Robonona'. Janë vlerësuar kostot dhe të hyrat në vijim:

1. Duhet të ndërtohet një fabrikë e re, për t'u përdorur vetëm për prodhimin e 'Robonona'. Ndërtimi i saj do të zgjas afër një vit dhe pritet të kushtojë €11.75 milion gjithsej, që do të paguhet me dy këste. Kësti i parë prej €6 milion do të paguhet me fillimin e punës në ndërtim (viti zero) dhe kësti i dytë i mbetur kur puna e ndërtimit të përfundoj në fund të vitit.
2. Pastrimi Shpk menjëherë do të hyjë në një kontratë njëvjeçare me një kompani për menaxhimin e projektit, e cila do të mbikqyrë ndërtimin e fabrikës. Kosto totale e kësaj do të jetë €250,000. Dy linja prodhimi do të nevojiten të instalohen në fabrikë me një kosto totale prej €1,500,000 të pagueshme në fund të vitit pas ndërtimit.
3. Makinaria për prodhimin e 'Robonona' poashtu duhet të ndërtohet sipas porosisë dhe pritet të kushtojë €2.5 milion, e pagueshme pas një viti. Vlera e mbetur e saj do të jetë zero. Zhvlerësimi do të filloj të ngarkohet menjëherë pas fillimit të prodhimit (menjëherë pas përfundimit të ndërtimit pas një viti) me normën vjetore 10% me metodën drejtvizore. Kosto e mirëmbajtjes së makinerisë vlerësohet të jetë €250,000 në vit.
4. Prodhimi dhe shitja do të fillojnë në vitin pas ndërtimit të fabrikës. Sasitë e shitjeve dhe çmimet e 'Robonona' pritet të jenë si në vijim:

Vitet	1	2	3 dhe 4 (çdo vit)	5 deri 9 (çdo vit)
Vëllimi i shitjeve ('000 njësi)	5	10	30	50
Çmimi i shitjeve (€)	1,000	800	700	500

Parashikohet që në fillim të vitit të 10, një ndihmës i ri robotik të zëvendësoj 'Robonona', prandaj nuk do të ketë shitje të mëtutjeshme të 'Robonona'.

5. Kosto e materialeve për 'Robonona' pritet të jetë €125 për njësi.
6. Kosto e punës pritet të jetë €100 për njësi.
7. Shpenzimet fikse të përgjithshme për fabrikën e re vlerësohet të jenë €240,000 në vit. Shpenzimet variabile të përgjithshme pritet të jenë €50 për njësi.
8. Kostot e zyrës qendrore prej €4.5 milion në vit do të alokohen në produktin 'Robonona' kur të filloj prodhimi. Nga këto kosto, vetëm €3.7 milion do të jenë kosto shtesë (relevante).
9. Paraqitja e 'Robonona' pritet të ndikojë negativisht në shitjen e 'Robostrimi'. Mendohet që për çdo dy njësi të shitura të 'Robonona', një njësi e "Robostrimi" të humbet. 'Robostrimi' momentalisht shitet për €150 për njësi dhe krijon një rrjedhë neto të parasë prej €50 për njësi.
10. Kosto e kapitalit të kompanisë është 5%.
11. Supozoni se e gjithë rrjedha e parasë ndodhë në fund të vitit, përveç nëse thuhet ndryshe.
12. Të gjitha llogaritjet duhet të jenë në mijëra euro ('000)

**Kërkohe:**

- (a) Duket përdorur tabelat e dhëna të skontimit, llogaritni vlerën neto të tanishme (VNT) të projektit sipas kostos së kapitalit të kompanisë. Japni një konkludim nëse Pastrimi Shpk duhet të vazhdojë me projektin. (20 pikë)
- (b) Listoni së paku tri përparësi të përdorimit të metodave të cilat aplikojnë rrjedhjet e skontuara të parasë (RrSA) në krahasim me metodat e tjera të vlerësimit të projekteve kapitale. (5 pikë)

(total = 25 pikë)

**Tabela e vlerës së tanishme (ekstrakt)**

Periudha (n)	Norma e skontimit (r)
	5%
1	0.952
2	0.907
3	0.864
4	0.823
5	0.784
6	0.746
7	0.711
8	0.677
9	0.645
10	0.614

**Tabela e faktorit të anuiteteve**

Periudha (n)	Norma e skontimit (r)
	5%
1	0.952
2	1.859
3	2.723
4	3.546
5	4.329
6	5.076
7	5.786
8	6.463
9	7.108
10	7.722

## Problemi 1 - Zgjidhja

(a)

	Koha						
	0	1	2	3	4	5	6-10
	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000
Kosto e hulumt. tregut (të fshehura)							
Kosto e zhvillimit (të fshehura)							
Kosto e fabrikës	(6,000)	(5,750)					
Menaxhimi i projektit		(250)					
Kosto e makinerisë		(2,500)					
Zhvlerësimi (jo me para)							
Mirëmbajtja			(250)	(250)	(250)	(250)	(250)
Linjat e prodhimit		(1,500)					
Të hyrat nga shitja			5,000	8,000	21,000	21,000	25,000
Kosto e materialit			(625)	(1,250)	(3,750)	(3,750)	(6,250)
Puna			(500)	(1,000)	(3,000)	(3,000)	(5,000)
Shpenz. e përgj. Fikse (relevante si kosto grumbulluese)			(240)	(240)	(240)	(240)	(240)
Shpenz. e përgj. variab (vetëm elementi grumbullues)			(250)	(500)	(1,500)	(1,500)	(2,500)
Kosto e zyrës kryesore (vetëm elementi shtesë)			(3,700)	(3,700)	(3,700)	(3,700)	(3,700)
Kontributi i zvogëluar i Robostrimi			(125)	(250)	(750)	(750)	(1,250)
Rrjedha neto e parasë	(6,000)	(10,000)	(690)	810	7,810	7,810	5,810
Faktori skontues	1	0.952	0.907	0.864	0.823	0.784	3.393
Rrjedha neto e skontuar e parasë	(6,000)	(9,520)	(626)	700	6,428	6,123	19,713

Vlera neto e tanishme e projektit është €16.818 milion. Prandaj kompania duhet të vazhdoj me projektin.

Llogaritjet

$$\text{Vitet } 6 - 10 = 7.722 - 4.329 = 3.393$$

(b)

Metodat që përdorin RrSA për vlerësimin e projekteve kanë disa epërsi mbi metodat e tjera të vlerësimit të tyre [projekteve].

-Mbahet parasysh vlera e parasë në kohë.

-Metoda mban parasysh të gjitha rrjedhjet e parasë së gatshme të projektit.

-Mban parasysh kohën kur ndodhin rrjedhjet e parasë së gatshme.

-VTN / NPV - ja dhe NBK / IRR - ja janë metoda të llogaritjes të pranuar në mënyrë universale.

## Problemi 2

(a) Një shitës i madh me pakicë i cili ka shumë dyqane dhe markete ka një depo qendrore prej të cilës furnizohen dyqanet dhe marketet në fjalë. Për pjesë Numër SF525 kemi në dispozicion informacionet e mëposhtme.

Përdorimi mesatar	350 në ditë
Përdorimi minimal	180 në ditë
Përdorimi maksimal	420 në ditë
Koha e përmbush. porosisë	11-15 ditë
Sasia e porosisë së re	6,500 njësi
Niveli i porosisë së re	6,300 njësi

*Kërkohet:*

**(i) Te llogaritet niveli maksimal i stoqeve? (3 pikë)**

**(ii) cili është numri i përafërt i Pjesëve Numër SF525 që mbahet si stoqe për amortizim (7 pikë)**

(a) Duke u bazuar në të dhënat më sipër, cili është niveli maksimal i stoqeve?

A 5,250                      B 6,500                      C 10,820                      D 12,800

(b) Duke u bazuar në të dhëna më sipër, cili është numri i përafërt i Pjesëve Numër SF525 që mbahet si stoqe për amortizim?

A 200                      B 720                      C 1,680                      D 1,750

(b) Kërkesa vjetore për një artikull të ndërmarrjes STEFO LLC është 45 njësi. Një njësi e artikullit kushton €200 për tu blerë, ndërsa kostoja e mbajtjes për një njësi për një vit është 15% e koston për njësi ndërsa koston e porositjes janë €300 një porosi [mandat blerje].

Furnitori ofron një 3% zbritje nëse porositen 60 ose më shumë njësi, dhe një zbritje prej 5% nëse porositen 90 ose më shumë njësi.

*Kërkohet*

**(i) Llogarisni madhësinë e porosisë në mënyrë që të minimizohen koston. (9 pikë)**

**(ii) A ka levërdi ndërmarrja të porosis 60 njësi në mënyrë që të përfitoj 3% zbritje. (3 pikë)**

**(iii) A ka levërdi ndërmarrja të porosis 90 njësi në mënyrë që të përfitoj 5% zbritje. (3 pikë)**

**(totali = 25 pikë)**

## Zgjidhja e problemi 2

(a)

(i) Niveli maksimal i stoqeve = niveli për porosi të re + sasia që duhet të porositet – (përdorimi minimal × koha minimale e përmbushjes së porosisë)

$$= 6,300 + 6,500 - (180 \times 11) \\ = 10,820 \text{ njësi}$$

(ii) Stoqe për amortizim = niveli minimal

$$\text{Niveli minimal} = \text{niveli për porosi të re} - (\text{përdorimi mesatar} \times \text{koha mesatare e përmbushjes së porosisë}) \\ = 6,300 - (350 \times 13) = 1,750 \text{ njësi}$$

(b)

(i) SPE – ja pa marrë parasysh zbritjen është  $\sqrt{\frac{2 \times 300 \times 45}{15\% \text{ of } 200}} = 30$

	€
Blerjet (pa zbritje) $45 \times \text{€}200$	9,000
Kostot e ruajtjes (Ë1)	450
Kostot e porositjes (Ë2)	<u>450</u>
Kostot totale vjetore	<u>9,900</u>

### Llogaritjet

#### 1 Kostot e ruajtjes

Kostot e ruajtjes = Stoqet mesatare × kostoja e mbajtjes për një njësi të stoqeve për vit

$$\text{Stoqet mesatare} = \text{Sasia që duhet të porositet} \div 2 \\ = 30 \div 2 = 15 \text{ njësi}$$

$$\text{Kostoja e mbajtjes për një njësi të stoqeve për vit} = 15\% \times \text{€}200 \\ = \text{€}30$$

$$\therefore \text{Kostot e ruajtjes} = 15 \text{ njësi} \times \text{€}30 \\ = \text{€}450$$

#### 2 Kostot e porositjes

Kostot e porositjes = numri i porosive × kostot e porositjes për secilin mandat blerje (€300)

$$\text{Numri i porosive} = \text{Kërkesa vjetore} \div \text{sasia që duhet të porositet} \\ = 45 \div 30 \\ = 1.5 \text{ porosi}$$

$$\therefore \text{Kostot e porositjes} = 1.5 \text{ porosi} \times \text{€}300 \\ = \text{€}450$$

(ii) Me një zbritje prej 3% dhe sasi që duhet të porositet prej 60, kostot për njësi janë si më poshtë.

	€
Blerjet $\text{€}9,000 \times 97\%$	8,730
Kostot e ruajtjes (Ë3)	873
Kostot e porositjes (Ë4)	<u>225</u>
Kostot totale vjetore	<u>9,828</u>

### Llogaritjet

#### 3 Kostot e ruajtjes

Kostot e ruajtjes = Stoqet mesatare × kostoja e mbajtjes për një njësi të stoqeve për vit

$$\text{Stoqet mesatare} = \text{Sasia që duhet të porositet} \div 2 \\ = 60 \div 2 = 30 \text{ njësi}$$

$$\text{Kostoja e mbajtjes për një njësi të stoqeve për vit} = 15\% \times 97\% \times \text{€}200 = \text{€}29.10$$

Vini re.  $97\% = 100\% - 3\%$  zbritje

$$\therefore \text{Kostot e ruajtjes} = 30 \text{ njësi} \times \text{€}29.10 \\ = \text{€}873$$

#### 4 Kostot e porositjes

Kostot e porositjes = numri i porosive  $\times$  kostot e porositjes për secilin mandat blerje (€300)

$$\begin{aligned}\text{Numri i porosive} &= \text{Kërkesa vjetore} \div \text{sasia që duhet të porositet} \\ &= 45 \div 60 \\ &= 0.75 \text{ porosi}\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}\therefore \text{Kostot e porositjes} &= 0.75 \text{ porosi} \times \text{€}300 \\ &= \text{€}225\end{aligned}$$

(iii) Me një zbritje prej 5% dhe sasi që duhet të porositet prej 90, kostot për njësi janë si vijon.

	€
Blerjet €9,000 $\times$ 95%	8,550.0
Kostot e ruajtjes (€5)	1,282.5
Kostot e porositjes (€6)	<u>150.0</u>
Kostot totale vjetore	<u>9,982.5</u>

*Llogaritjet*

#### 5 Kostot e ruajtjes

Kostot e ruajtjes = Stoqet mesatare  $\times$  kostoja e mbajtjes për një njësi e stokeve për vit

$$\begin{aligned}\text{Stoqet mesatare} &= \text{sasia që duhet të porositet} \div 2 \\ &= 90 \div 2 \\ &= 45 \text{ njësi}\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}\text{Kostoja e mbajtjes për një njësi të stokeve për vit} &= 15\% \times 95\% \times \text{€}200 \\ &= \text{€}28.50\end{aligned}$$

*Shënim.* 95% = 100% – 5% zbritje

$$\begin{aligned}\therefore \text{Kostot e ruajtjes} &= 45 \text{ njësi} \times \text{€}28.50 \\ &= \text{€}1,282.50\end{aligned}$$

#### 6 Kostot e porositjes

Kostot e porositjes = numri i porosive  $\times$  kostot e porositjes për secilin mandat blerje (€300)

$$\begin{aligned}\text{numri i porosive} &= \text{Kërkesa vjetore} \div \text{sasia që duhet të porositet} \\ &= 45 \div 90 \\ &= 0.5 \text{ porosi}\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}\therefore \text{kostot e porositjes} &= 0.5 \text{ porosi} \times \text{€}300 \\ &= \text{€}150\end{aligned}$$

**Mundësia më e lirë është të porositen 60 njësi në një kohë.**

Vini re se vlera e  $C_H$  ka ndryshuar sipas madhësisë së zbritjes, për arsye se  $C_H$  ishte një përqindje e kostos së blerjes. Kjo do të thotë se **kostot totale të ruajtjes janë zvogëluar për shkak të zbritjes**. Një gjë e tillë do të kishte qenë më e dukshme nëse, për shembull, shumica e  $C_H$  –së do të kishte qenë kosto e sigurimit, vlera e të cilës bazohet mbi koston e stokeve të mbajtura.



### Problemi 3

Ekstrakti nga pasqyrat financiare të audituara të klientit tuaj, AMIGO LLC, janë prezantuar si në vijim:

**AMIGO  
LLC**

**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 mars 2019**

<b>Totali i pasurive jo-qarkulluese</b>	<b>€000s</b> 3,600
<b>Totali i pasurive qarkulluese</b>	1,400
<b>Totali i pasurive</b>	<u>5,000</u>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>	
<b>Kapitali</b>	
Aksionet e zakonshme (@ €1)	1,400
10% €1 Aksionet preferenciale kumulative të paribleshme	600
Rezervat tjera	800
	<u>2,800</u>
<b>Detyrimet afatgjata</b>	
6% €100 Kreditë e paribleshme	1,000
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	1,200
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>	<u>5,000</u>

**Shënime:**

- Aksionet e zakonshme janë duke u tregtuar me çmim prej €6.30 cum div.
- Aksionet preferenciale janë duke u tregtuar me çmim prej €4.20 ex div.
- Çmimi aktual i kredive të paribleshme është €110.
- Për vitin e përfunduar më 31 mars 2019, është deklaruar dividenda prej €0.30/aksion e cila ende nuk është paguar.
- Dividenda preferenciale për vitin e përfunduar më 31 mars 2019 është paguar.
- Fitimi para tatimit dhe interesit për vitin që përfundon më 31 mars 2019 ishte €800,000.
- Tatimi në fitim është 20%.
- Ju keni përlllogaritur se norma mesatare e rritjes së dividendës së aksioneve të rregullta gjatë katër viteve të fundit ishte 2%. Kjo normë e rritjes pritet të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme.

**Kërkohet:**

- a) Përlllogarisni fitimin e mbajtur për vitin e përfunduar më 31 mars 2019. (8 pikë)
- b) Përlllogarisni WACC të kompanisë AMIGO LLC. (13 pikë)
- (c) Listoni dy arsye pse një kompani duhet ta kuptoj WACC-në e saj. (4 pikë)
- (Totali = 25 pikë)

## Zgjidhje e problemit - 3

a)

AMIGO LLC

Fitimi i mbjatur - 31 mars 2019	€000
Fitimi para interesit dhe tatimit	800
Interesi i pagueshëm	-60
Fitimi para tatimit	740
Tatimi @ 20%	-148
Fitimi neto	592
Dividenda preferenciale	-60
Dividenda e zakonshme	-420
<b>Fitimi i mbajtur</b>	<b>112</b>

b)

Përlllogaritja e WACC-së (KMPK)

WACC	Shënim	V.Tregut	% Kosto	% Ponderi	E ponderuar
Aksionet e zakonshme (ex div)	1	8,400,000	7.10%	69.88%	4.96%
Aksionet preferenciale (ex div)	2	2,520,000	2.38%	20.97%	0.50%
Kreditë e paribleshme	3	1,100,000	4.36%	9.15%	0.40%
<b>WACC</b>		<b>12,020,000</b>		<b>100.00%</b>	<b><u>5.86%</u></b>

### Shënim 1) Kosto e ekuitetit

$$[.30*(1+.02)/(6.30- .30)] +.02 = 7.10\%$$

### Shënim 2) Kosto e aksioneve preferenciale

$$\text{Dividenda/Vlera e tregut ex-div} = 60/2520 * 100 = 2.38\%$$

### 3) Kosto e kredive

$$(\text{Interesi} - \text{Tatimet})/\text{Vlera e tregut} = (60*.8)/1100 * 100 = 4.36\%$$

Arsyjet pse një kompani duhet ta kuptoj WACC (KMPK) të saj;

- 1) Për të përcaktuar nëse ekzistojnë burime më të lira të financimit.
- 2) Për të konsideruar ndikimin e një burimi të ri të financimit në WACC.
- 3) Për të konsideruar vlerën e tregut të kompanisë.
- 4) Për ta përdorur si normë skontuese gjatë vlerësimit të investimeve kapitale.

## Problemi 4

PRISHTINA LLC është duke konsideruar këto ndryshime sa i përket menaxhimit të kapitalit qarkullues:

### I. Menaxhimi i stoqeve

Është sugjeruar se madhësia e porosisë për produktin KN5 duhet të përcaktohet nëpërmjet të modelit të sasisë së porosisë ekonomike (SPE/EOQ).

PRISHTINA LLC parashikon se kërkesa për produktin KN5 për vitin në vijim do të jetë 160,000 njësi dhe në të kaluarën madhësia e porosisë për këtë produkt ka qenë sa 10% e kërkesës vjetore. Kosto e porositjes pritet të jetë €400 për porosi, ndërkaq kosto e mbajtjes pritet të jetë €5.12 për njësi. Një sasi rezervë prej 5,000 njësi të produktit KN5 do të mbahet gjatë gjithë kohës, pa marrë parasysh se çfarë metode për përcaktimin e madhësisë së porosisë përdoret (SPE/EOQ apo metoda e aplikuar në të kaluarën).

### II. Menaxhimi i të llogarive të arkëtueshme

PRISHTINA LLC mund të aplikoj një zbritje prej 1% për klientët të cilët i paguajnë borxhet brenda 30 ditëve, dhe në të njëjtën kohë, nëpërmjet procedurave të reja operationale, të mirëmbaj në maksimum një periudhë mesatare të shlyerjes së llogarive të arkëtueshme prej 60 ditëve, për klientët të cilët nuk e shfrytëzojnë zbritjen. Nëse politika e re vihet në zbatim është vlerësuar se 25% e klientëve do ta shfrytëzojnë ofertën e pagesës brenda 30 ditëve.

Është vlerësuar se kursimi i shpenzimeve administrative dhe operationale do të jetë €753,000 në vit, si rezultat i përmirësimit të procedurave operationale dhe implementimit të politikës së re të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme.

Shitjet me kredi të kompanisë PRISHTINA LLC aktualisht janë €87.6 milion në vit dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare aktualisht janë €18 milion. Shitjet me kredi (afat pagese) nuk parashihen të ndryshojnë si rezultat i ndryshimit në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme. Kosto afatshkurtër e financimit të kompanisë është 5.5% në vit.

#### *Kërkohet:*

(a) Kalkuloni koston e politikës aktuale të porositjes dhe ndryshimin në kosto të menaxhimit të stoqeve që do të rezultojë nëse kompania aplikon modelin e sasisë së porosisë ekonomike në përcaktimin e madhësisë së porositjes së Produktit KN5.

(8 pikë)

(b) Shpjegoni shkurtimisht përfitimet nga aplikimi i politikës së prokurimit pikërisht-në-kohë (PNK/JIT).

(5 pikë)

(c) Kalkuloni dhe komentoni nëse ndryshimet e propozuara në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme do të jenë të pranueshme. Duke supozuar se vetëm 25% të klientëve e shfrytëzojnë zbritjen nga pagesa e mëhershme, cila është zbritja maksimale e cilat mund t'u ofrohet klientëve për pagesë të mëhershme.

(7 pikë)

(d) Diskutoni faktorët të cilët duhet të merren parasysh gjatë përpilimit të politikës së kapitalit qarkullues në lidhje me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme tregtare.

(5 pikë)

(Totali = 25 pikë)

## Zgjidhje e problemit - 4

(a)

### Kosto e politikës aktuale të porositjes

Madhësia e porositjes = 10% of 160,000 = 16,000 njësi për porosi

Numri i porositjeve në vit = 160,000/16,000 = 10 porositje në vit

Kosto vjetore e porositjes = 10 x 400 = €4,000 në vit

Kosto e mbajtjes duke injoruar stoqet rezervë = 5·12 x (16,000/2) = €40,960 në vit

Kosto e mbajtjes së stoqeve rezervë = 5·12 x 5,000 = €25,600 në vit

Kosto totale e politikës aktuale = 4,000 + 40,960 + 25,600 = €70,560 në vit

### Kosto e politikës së porositjes sipas modelit SPE/EOQ

Madhësia e porositjes = (2 x 400 x 160,000/5·12)0·5 = 5,000 njësi për porosi

Numri i porositjeve në vit = 160,000/5,000 = 32 porosi për vit

Kosto vjetore e porositjes = 32 x 400 = €12,800 për vit

Kosto e mbajtjes duke injoruar stoqet rezervë = 5·12 x (5,000/2) = €12,800 në vit

Kosto e mbajtjes së stoqeve rezervë = 5·12 x 5,000 = €25,600 në vit

Kosto totale e politikës SPE/EOQ = 12,800 + 12,800 + 25,600 = €51,200 në vit

### Ndryshimi në kostot e menaxhimit të stoqeve sipas modelit SPE/EOQ

Zvogëlimi në kosto = 70,560 – 51,200 = €19,360

(b)

Kostot e mbajtjes mund të reduktohen duke zvogëluar nivelin e stoqeve të mbajtura nga kompania. Kostot e mbajtjes mund të reduktohen në minimum nëse kompania bën porositjen e tyre vetëm atëherë kur paraqitet kërkesa për to, duke shmangur nevojën që të kenë nivele të stoqeve rezervë gjatë procesit të prodhimit. Kjo qasje e menaxhimit të stoqeve njihet si prokurimi pikërisht-në-kohë (PNK/JIT).

Përfitimet e prokurimit PNK/JIT përfshijnë nivele më të ulëta të investimit në kapital qarkullues, pasi që nivelet e stoqeve janë minimizuar; reduktim në kostot e mbajtjes së stoqeve; reduktim në kostot e ruajtjes së materialeve; marrëdhënie e përmirësuar me furnitorët, pasi që furnitorët dhe klientët duhet të punojnë për së afërmi në një sistem PNK/JIT; kosto më të ulëta të ripunimit si rezultat i rritjes së theksit në kualitetin e furnizimeve.

(c)

### Vlerësimi i ndryshimeve në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Numri aktual i ditëve në llogaritë e arkëtueshme = (18/87·6) x 365 = 75 ditë

Pasi që 25% e klientëve do ta shfrytëzojnë zbritjen, atëherë 75% nuk do të shfrytëzojnë.

Numri i korrigjuar i ditëve në llogaritë e arkëtueshme = (0·25 x 30) + (0·75 x 60) = 52·5 ditë

Niveli aktual i llogarive të arkëtueshme tregtare = €18m

Niveli i korrigjuar i llogarive të arkëtueshme tregtare = 87·6 x (52·5/365) = €12·6m

**Reduktimi = 18 – 12·6 = €5·4m**

Kosto e financimit afatshkurtër = 5.5%

Reduktimi në kostot e financimit = 5·4m x 0·055 = €297,000

Kursimet në kostot e administrimit dhe ato operative = €753,000

**a. Përfitimet totale = 297,000 + 753,000 = €1,050,000**

**b. Kosto nga aplikimi i politikës së zbritjes = 87·6m x 0·25 x 0·01 = €219,000**

**a-b. Përfitimi neto nga aplikimi i politikës së zbritjes = 1,050,000 – 219,000 = €831,000**

Ndryshimet e propozuara në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme janë të pranueshme, edhe pse ato varen nga parashikimi i kursimeve në kostot administrative dhe operative.

### Zbritja maksimale nga pagesat e mëhershme

Duke krahasuar përfitimet totale të €1,050,000 me 25% të shitjeve vjetore me kredi të €87,600,000, që është €21,900,000, maksimumi i zbritjes nga pagesat e mëhershme që mund të ofrohet është 4.8% (1·050/21·9)).

(d)

Faktorët të cilët duhet të merren parasysh janë:

### **Niveli i investimeve në llogaritë e arkëtueshme tregtare**

Nëse shuma e financimit e ndërlidhur me llogaritë e arkëtueshme është substanciale, atëherë politika e menaxhimit të arkëtueshmeve duhet të orientohet në reduktimin e nivelit të investimit duke pasur kontrollë më të rrepta gjatë shitjeve me kredi dhe duke aplikuar metoda për vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve.

### **Kosto e financimit të kredisë tregtare**

Nëse kosto e financimit të kredisë tregtare është e lartë, atëherë do të ekzistoj presion për reduktimin e shumës së kredisë së ofruar dhe të reduktohet periudha për të cilën kredia është ofruar.

### **Kushtet tregtare të ofruara nga konkurrenca**

Në mënyrë që të bëhet një konkurrencë më efektive, kompania do të ketë nevojë të krahasoj kushtet e ofruara nga konkurrentët e saj, përndryshe klientët do të migrojnë te ata, përveç nëse ekzistojnë faktorë tjerë të cilët do ti inkurajojnë klientët të jenë lojal, si për shembull produkte të kualitetit të lartë ose shërbim më të vlerësuar të pas-shitjes.

### **Niveli i rrezikut të pranueshëm nga kompania**

Disa kompani mund të pretendojnë se kushtet më të lehta të kredive tregtare (shitjeve me afat pagese) do të ndikojnë në rritjen e vëllimit të shitjeve deri në atë nivel që të kompensohet rreziku më i lartë i borxheve të këqija. Niveli i pranueshëm i rrezikut i borxheve të këqija do të ndryshojë nga një kompani në tjetrën. Disa kompani mund të kërkojnë të reduktojnë këtë rrezik nëpërmjet politikës e cila bën sigurimin nga mos-pagesa e klientëve.

### **Nevoja për likuiditet**

Në rastet kur nevoja për likuiditet është e lartë, kompania mund të zgjedhë të përshpejtoj rrjedhjet hyrëse të parasë nga klientët e tyre nëpërmjet vendosjes së zbritjes së ofruar në faturat e lëshuara ose nëpërmjet faktoringut.

### **Ekspertiza në dispozicion brenda kompanisë**

Në rastet kur ekspertiza në vlerësimin e aftësisë paguese dhe monitorimin e klientëve është e mangët, atëherë kompania mund të zgjedhë të ia ofroj një kompanie *faktor* menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.